



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.12.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen , i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Vlora Mehmeti, mbështetur nga Jusuf Kryeziu (Udhëheqës Ekipi), Igballe Halili dhe Aida Podrimaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	23
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	26

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 04/10/2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare – pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe çështjet e tjera të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale* **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrolleve të brendshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është dizajnuar në mënyrë të duhur dhe ka funksionur mirë me përjashtim të disa rasteve të cilat duhet të merren parasysh me qëllim që të mos ulin kredibilitetin e sistemeve të kontrollit.

Konkludimi ynë lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin është se një progres i lehtë është shënuar që nga viti 2012 në fushën e menaxhimit të shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit. Pavarësisht kësaj, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të ngritë nivelin e kontrolleve në fushën e planifikimit dhe realizimit buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale për të siguruar rritjen e efikasitetit dhe infrastrukturës së pushtetit lokal. Për këtë qëllim shtimi i bashkëpunimit me Komuna është më se i domosdoshëm.

Po ashtu, rishikimi i kontrolleve është i nevojshëm në procesin e mbikëqyrjes së projekteve kapitale nga ana e ministrisë, menaxhimit e borgjeve dhe pasurisë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin menaxhmentin në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2012. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka një progres sa i përket implementimit të rekomandimeve nga vitet paraprake në fushën e shpenzimeve. Megjithatë, testimet tona kanë vënë në pah që mangësit e njëjta në disa fusha janë evidente dhe veprimet konkrete duhet të merren për evitimin e tyre.

Rekomandimet tona kryesore për Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal janë si në vijim:

- Të angazhohet edhe më tutje në adresimin e plotë të rekomandimeve tona. Sidomos është shqetësuese fakti që disa rekomandime janë përsëritur prej vitit në vit. Ministri duhet të analizoj mirë të gjitha rekomandimet e dhëna dhe të marrë masa për adresimin e plotë të tyre;
- Të analizoj arsyet në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit që ndërlidhen me investimet kapitale, si dhe të eliminoj dobësit qoftë në fazën e planifikimit ose në fazën e ekzekutimit të buxhetit;
- Të siguroj krijimin e një mjedisi transparent të kontrollit në menaxhimin e prokurimit, duke filluar nga përgatitja e një plani të mirëfillt të prokurimit, inicimi i procedurave e deri tek mbikëqyrja e kontratave. Më tutje, duhet të shtoj bashkëpunimin me Komunitet për planifikimin e projekteve kapitale; dhe
- Të vendos një sistem funksional të kontrollit rreth menaxhimit të borgjeve për të mos ngarkuar vitin vijues fiskal me obligime të vitit paraprak dhe të vendos kontrolle në menaxhimin e pasurisë, për të siguruar që Ministria e mirëmban/azhurnon çdo vit regjistrin e pasurisë.

Përgjigja e Ministrit – auditimi 2013

Ministri është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do të adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i veprimeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

MAPL ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar**).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Rregullën e MF-nr 03/2013-Për Pasqyrat financiare vjetore të organizatve buxhetore; dhe
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Marrë parasysh këtë - Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga MAPL-ja kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit me kohë;
- Raportet për borxhet e papaguara; dhe
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000 janë dorzuar në MF.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto. MAPL ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm me cilsin e duhur dhe duke i respektuar afatet kohore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Që prej pranimit të rekomandimeve tona në korrik 2013 për vitin 2012, Administrata e MAPL-së ka ndërmarrë masa për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Ka një progres sa i përket adresimit të rekomandimeve, por edhe më tutje disa çështje mbeten për t'u adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 ka rezultuar me njëmbëdhjet rekomandime. MAPL ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, pesë (5) rekomandime janë adresuar plotësisht; tri (3) janë adresuar pjesërisht, dhe tri (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimet

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Rekomandimet nga viti i kaluar nuk janë adresuar plotësisht, në veçanti në prokurim dhe menaxhimin e pasurive.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare kanë rezultuar në:

- Jo-efikasitet të vazhdueshëm në planifikimin dhe realizimin e buxhetit sidomos në kapitale, dhe
- Mangësi në respektimin e procedurave të shpenzimeve dhe kategorizimit të tyre.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për fushat me mangësi të theksuara rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato adresohen plotësisht nga stafi llogaridhënes..

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale.

Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se MAPL ka dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm megjithatë nuk ka gjeturë zbatim në të gjitha rastet. Përmirësime të mëtutjeshme nevojiten në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe procedurave të prokurimit. Përderisa, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet menaxhimit të borgjeve. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për MAPL, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,993,623	6,138,693	4,919,403	5,792,704	7,680,745
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,993,623	5,992,002	4,877,197	5,752,550	7,679,345
Donacionet e jashtme	-	146,691	42,206	40,154	1,400

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë si rezultat i donacioneve të jashtme. Kjo rritje ka ndodhur pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2013, MAPL ka realizuar 80% të buxhet final ose 4,919,403€, ky është një nivel më i ulët se vitin paraprak (2012). Ekzekutimi i buxhetit vazhdon të mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	5,993,623	6,138,693	4,919,403	5,792,704	7,680,745
Pagat dhe Mëditjet	756,746	734,546	666,931	696,535	726,375
Mallrat dhe Shërbimet	306,054	539,898	390,365	649,265	413,051
Shërbimet komunale	30,000	30,000	25,724	23,401	37,661
Subvencionet dhe Transferet	437,249	477,319	468,125	390,063	408,164
Investimet Kapitale	4,300,000	4,356,930	3,368,258	4,033,440	6,095,493
Rezervat	163,574 ³				

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për Paga dhe Mëditje është zvogëluar për 2.9%, përderisa realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 90%.

Te kategoria e Mallrave dhe shërbimeve kemi një rritje të buxhetit final në raport me buxhetin fillestar në vlerë prej 233,844€. Të gjitha lëvizjet janë bërë në bazë të vendimeve të Qeverisë. Realizimi i Buxhetit për këtë kategori për vitin 2013 është rreth 73%.

Buxheti për Subvencione dhe Transfere gjatë vitit është rritur për 40,070€ose shprehur në përqindje për 9%. MAPL kishte një realizim të mirë të buxhetit në këtë kategori, rreth 98%.

³ Buxheti fillestar në kategorinë e Rezervës, ka qenë 163,574€. Nga kjo shumë në kategorinë Mallra dhe Shërbime, janë alokuar mjete në shumë prej 85,574€, kurse mjetet në shumë prej 78,000€, janë transferuar konform vendimit të qeverisë në buxhetin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut, për pagesën e shtesave të rrezikshmërisë për zyrtarët e ZAMV.

Buxheti për Investime Kapitale gjatë vitit është rritur për 56,930€, ndërsa vetëm 77% e buxhetit për këtë kategori është realizuar. Programi për Investime Publike me buxhet fillestar përfshin tri (3) projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe dy projekte të reja për vitin 2013.

MAPL ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në vlerën 146,691€, prej tyre gjatë vitit 2013 janë shpenzuar 42,206€.

Rekomandimet

Çështja 2 – Ekzekutimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

E gjetura Ekzekutimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Pavarësisht rritjes së buxhetit gjatë vitit 2013, MAPL nuk kishte arritur të realizojë në tërësi buxhetin e saj për këtë vit. Shprehur në përqindje buxheti ishte realizuar 80%, ekzekutim i ulët vërehet posaçërisht në kategoritë investime kapitale dhe mallra dhe shërbime. Sipas MAPL-së, në ekzekutimin e ulët të buxhetit të vitit 2013, ka ndikuar mos shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomikë në tri projekte nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës në përgjithësi. Ekzekutimi i ulët i buxhetit në veçanti për investimet kapitale të cilat janë dedikuar për rritjen e efikasitetit të pushtetit lokal rrezikon zhvillimin ekonomik lokal dhe mund të shkaktojë ngecje në reformimin e administratës lokale. Mos-përmbushja e planit të shpenzimeve do të rezultojë në uljen e efikasitetit të MAPL-së.

Rekomandimi 2 Ministri duhet ta bëjë një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit në tërësi, si dhe të eliminojë dobësitë qoftë në fazën e planifikimit ose fazën e ekzekutimit të buxhetit.

Çështja 3 - Realizimi i buxhetit në tremujorin e fundit – Prioritet i lartë

E gjetura	Pjesa më madhe e buxhetit për kategorin e investimeve kapitale është realizuar në tremujorin e fundit e në veçanti në muajin e fundit të vitit. Nga gjithsej 3,368,258€ shpenzime të realizuara në vitin 2013, 2,336,203€ janë realizuar në tremujorin e fundit.. Prej të cilave, 1,714,473€ ose mbi 50% janë realizuar vetëm në muajin e fundit (Dhjetor/2013).
Rreziku	Kjo bart rrezikun në vete se në tremujorin e fundit e veçanërisht në muajin fundit të ndodhin pagesa të shumta të cilat mund t'iu shmangen kontrolleve të duhura.
Rekomandimi 3	Ministri duhet siguroj një monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore në mënyrë që ta përmirësoj atë, gjithashtu të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.

4.2 Shpenzimet

4.2.1 Prokurimi

Përshkrimi

MAPL, në fillim të vitit 2013 kishte planifikuar shpenzime përmes prokurimit në vlerë prej 140,506€. Deri në fund të vitit 2013 kishte realizuar shpenzime përmes procesit të prokurimit në vlerë prej 627,103€. Prej tyre, 448,159€ janë realizuar në kategorin e investimeve kapitale ndërsa 178,944€ janë realizuar në mallra dhe shërbime.

Ekzistojnë disa raste kur nuk janë respektuar aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar, por në përgjithësi ka një progres në këtë aspekt me vitin e kaluar.

Testet tona të auditimi mbi procedurat e prokurimit identifikuan çështjet në vijim.

Rekomandimet

Çështja 4- Mangësi në planifikimin e prokurimeve – Prioritet i lartë

E gjetura Në planin e prokurimit ishin paraparë aktivitete të prokurimit për mallra dhe shërbime në vlerë prej 91,346€ ndërsa janë realizuar 178,994€. Për investime kapitale ishin paraparë aktivitete të prokurimit në vlerë prej 49,160€, ndërsa janë realizuar 448,159€. Vlera totale e shpenzimeve të prokurimit të cilat nuk ishin planifikuar në planin e prokurimit është 486,597€. Pjesa më e madhe e kësaj vlere janë realizuar për financimin e projekteve kapitale në Komuna. Këto mangësi kanë rezultuar si pasojë e komunikimit jo të mirë të MAPL-së dhe Komunave në fazën e përgatitjes të planit të prokurimit.

Përveq kësaj gjatë ekzaminimit të mostrës “Furnizim me Pajisje dhe Teknologji Informative” aktiviteti i prokurimit është realizuar në vlerë prej 56,929€, përderisa planifikimi për këtë furnizim ishte 39,160€.

Rreziku Mos identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime me kohë dhe përcaktimi jo i përafërt i vlerës së kontratës mund të ketë për pasojë procesimin e shpenzimeve jo në përputhje me rregullat në fuqi. Po ashtu mund të sjellin MAPL-në në vështirësi financiare duke hyrë në obligime të reja të paplanifikuara dhe të rrezikojë realizimin e objektivave të parapara me plan.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të sigurojë se nevojat për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale janë identifikuar me kohë dhe vlera e përafërt e shpenzimit është përcaktuar me qëllim të reduktimit të rreziqeve/devijimeve nga rregullat ligjore.

Gjithashtu Ministri, duhet të shtojë nivelin e bashkëpunimit me Komunitet në fazën e planifikimit në mënyrë që të bëhet identifikimi i nevojave me kohë dhe të bëhet një planifikim i mirëfillt i shpenzimeve të prokurimit.

Çështja 5 – Nënshkrimi i kontratës pa zotim të mjeteve si dhe klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate – Prioritet i lartë

E gjetura Nënshkrimi i kontratës “Furnizim me pajisje të TI” në vlerë prej 56,929€ të cekur më lart është bërë pa zotimin e mjeteve. Fillimisht është bërë zotimi nga kategoria subvencioneve për entitete publike, pastaj është anuluar ky zotim dhe pas nënshkrimit të kontratës është bërë zotimi tjetër nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Në kategorinë e investimeve kapitale pagesat e transfereve kapitale për entitetet publike në vlerë prej 211,840€, nuk janë kategorizuar në kodin adekuat (33100 transfere kapitale për entitete publike) por janë kategorizuar në kapitale tjera. Përveq kësaj në kontratën “Furnizim me pajisje të TI” dy pajisje të TI të furnizuara ishin me vlerë individuale mbi 1,000€, MAPL i ka regjistruar në kodin ekonomik 13503 pajisje tjera nën 1,000€. Këto pajisje duhet të regjistrohen si shpenzime kapitale në kodin 31650.

Rreziku Nënshkrimi i kontratës në mungesë të zotimit të mjeteve është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe mund të sjellin MAPL-në në vështirësi financiare duke hyrë në obligime të reja. Ndërsa regjistrimet në kodet jo adekuate ndikojnë në humbjen e besueshmërisë në cilësinë e informatave të raportuara duke mbivlerësuar një kategori dhe nënvlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë se ka shtuar kujdesin para nënshkrimit të kontratës për të siguruar zotimin e mjeteve nga kategoria përkatëse si dhe gjatë procedimit të pagesave të siguroj që ato bëhen në përputhje me kodet në planin kontabël. .

Çështja 6 – Mbikëqyrja jo e mjaftueshme për projektet e investimeve kapitale – Prioritet i lartë

- E gjetura** Mbikëqyrja për projektet e Investimeve Kapitale nuk ishte e mjaftueshme dhe kjo duhet të zhvillohet më tutje. Pothuajse çdo vit, MAPL financon projekte kapitale në Komuna. Këto janë të rregulluara në bazë të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MiM) në mes të MAPL-së dhe Komunave. Ne kemi identifikuar çështjet në vijim:
- MAPL dhe Komuna e Skenderajt kanë lidhur një MiM për financimin e projektit “Ndërtimi i Objektit Administrativ të Kuvendit Komunal në Skenderaj” në vlerë prej 350,000€ për vitin 2013.
- Sipas MiM-së, Organi Mbikqyrës caktohet nga ana e Komunës. Përderisa, MAPL procesin e mbikëqyrjes (monitorimit) e realizon përmes dy inxhinierëve të fushës përkatëse. Mirëpo këta inxhinier raportojn (mbikëqyrin) duke u bazuar vetëm në raportin e përshkruar nga organi mbikëqyrës i Komunës.
- Rreziku** Mbikëqyrja e pamjaftueshme nga ana e MAPL-së për projektet e bashkëfinancimit mund të shpije deri tek shmangia e përgjigjesisë, llogaridhënies dhe transparencës.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të siguroj që janë forcuar mekanizmat e bashkëpunimit dhe ka shtuar mbikëqyrjen e vazhdueshme gjatë realizimit të projekteve kapitale të financuara nga MAPL në mënyrë që të ngritet përgjegjësia dhe llogaridhënia në nivel më të lartë.

Çështja 7 - Ndryshimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit nga MAPL-ja - Prioritet i lartë

- E gjetura** Me datën 05.07.2013, MAPL ka lidhur MeM me Ministrin për Kthim dhe Komunitete (MKK) dhe Komunën e Novobërdës për bashkëfinancimin e projektit “Asfaltimi i rrugës në fshatin Kufc e Epërme, Komuna e Novobërdës” Në MiM ishin përcaktuar obligimet e secilës palë të përfshirë, MAPL do të kontribuonte me 155,000€, MKK me 50,000€ dhe Komuna me 5,000€. Ndërkohë, MAPL ka lidhur edhe një MiM tjetër për shtrimin e trotuarit në të njëjtën rrugë në vlerë prej 40,000€, financues i të cilit ishte MAPL.
- Sipas MiM-së, MKK do të kryej pagesat e para pas dorëzimit të situacioneve për punët e kryera nga ana e kompanisë së kontraktuar.
- Pavararësisht MiM-së dhe pavarësisht që MKK kishte zotuar shumën e obliguar për pagesë (sipas konfirmimeve me shkrim të MAPL-së), MAPL me datën 06.12.2013 ka marrë përsipër kryerjen e obligimeve të MKK-së me arsyetimin se ka mjete të zotuar për shumën e kontratës.
- Situacionin të cilin MAPL e ka marr për obligim ta kryej (përfshirë obligimin e MKK-së) ishte në vlerë prej 106,197€. Nga kjo, obligim i Komunës ishte 5,000€. MAPL ka paguar 62,197€ dhe pjesën tjetër në vlerë prej 39,000€ e ka bartur për pagesë në vitin 2014.
- Rreziku** Ndryshimi i MiM-së në fund të vitit fiskal mund të ketë efekt negativ financiar të dyanshëm si për MKK -në ashtu edhe për MAPL-në. MKK mund të mos ketë arritur t’i shfrytëzoj mjetet në vlerë prej 50,000€ për vitin 2013, përkundër faktit që kanë qenë të zotuar për projektin në fjalë. Përderisa bartja e vlerës prej 39,000€ nga MAPL për pagesë në vitin vijues ka ndikuar në rritjen e obligimeve të papaguara (shih nën kapitullin 4.4 Trajtimi i borgjeve).
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të siguroj që në të ardhmen MiM-të respektohen plotësisht me qëllim që të eliminohen mangësi të njëjta. . Në rast të nevojës për ndryshime të MiM-së të merren parasysh të gjitha implikimet financiare që mund të pasojnë për të gjitha palët e përfshira në bashkëfinancim.

Çështja 8- Planifikim jo i mirë i nevojave për shërbime projektuese – Prioritet i lartë

E gjetura	MAPL ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetin “ Shërbime Projektuese për rrugë, ujësjellës, kanalizim atmosferik dhe kanalizim për fekalë”. Pas përfundimit të procedurave të prokurimit MAPL ka kontraktuar Operatorin Ekonomik (OE) i cili kishte ofruar çmimin më të lirë në total për katër projektet. Ne kemi vërejturë që, MAPL ka realizuar vetëm njërin nga katër shërbimet e kontraktuara, atë të projektimit për rrugë. Ne i kemi krahasuar çmimet e OE fitues dhe ofertuesve të tjerë për secilin projektim dhe kemi vërejturë që projektimi i rrugëve nga OE fitues ka kushtuar 8,890€, ndërsa sikur të realizohej po i njëjti projekt nga operatori tjetër i përgjegjshëm, do të kishte kushtuar 5,556€. Përderisa, çmimet e ofruara nga OE fitues për projeksionet për ujësjellës dhe kanalizim të cilat MAPL nuk i ka shfrytëzuar ishin të volitshme.
Rreziku	Mos planifikimi i mirë i nevojave reale të MAPL-së për projekte dhe mos shfrytëzimi i ofertave më të volitshme për projektimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, rrit rrezikun për shfrytëzim jo racional të parasë.
Rekomandimi 8	Ministri duhet të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit të bëhen analiza të duhura lidhur me nevojat reale të MAPL-së me qëllim që objektivat e caktuara të arrihen me një kosto më racionale.

4.2.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Këto shpenzime përfshijnë të gjitha blerjet që nuk kanë nevojë për procedura të prokurimit, siç janë shërbimet komunale, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e reprezentacionit dhe shpenzime tjera.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në MAPL kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme. Për vitin 2013, MAPL në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kishte planifikuar 734,546€, përderisa ka realizuar 666,931€, ose 90%.

Ne kemi identifikuar dobësi në sistemet e kontrollit që kanë mundur të përfshijë shtesave të dedikuara për shërbyes civil për një pjesë të kabinetit të Ministrit të cilët nuk janë pjesë e shërbyesve civil. Këto pagesa janë ndaluar në tërësi në fillim të vitit 2014.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Buxheti për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2013 ishte 477,319€ ndërsa shpenzimet për vitin 2013 ishin 468,125€ apo 98 %..

MAPL pothuaj çdo vit ndan mjete për financimin e komunave në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. MAPL ka nxjerrur rregulloren Nr. 03/2013 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, si dhe krijon marrëveshje të mirëkuptimit të veçantë për secilin projekt (subvencion).

Në këtë kategori ne kemi testuar njëmbëdhjetë mostra (pagesa) të selektuara nga regjistri i thesarit, në vlerë 149,799€. Dhe si rezultat i testimit të mostrave doli që MAPL në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e Subvencioneve dhe Transfereve.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Pasuritë dhe obligimet

4.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 4,815,020 €, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 559,159 €. Në PVF pasuritë janë paraqitur sipas vlerës së tyre neto.

Rekomandimet

Çështja 9 - Mangësi në Menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura MAPL e ka formuar komisionin për inventarizim dhe komisionin për vlerësim të pasurisë së saj. Mirëpo, këto komisione nuk i kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë e pritura konkretisht nuk kanë bërë inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë.

MAPL ka regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, mirëpo ky regjistër nuk është i plotë.

Rreziku Mungesa e inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrit të plotë të pasurive e rrit rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj se pasuritë menaxhohen sipas kërkesave ligjore për të siguruar që pasuritë ruhen nga humbja apo keqpërdorimi. Për këtë qëllim, duhet të siguroj që inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive kryhet çdo vit.

4.4 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

MAPL ka shpalosur obligimet e papaguara në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2013 në përputhje me rregullën financiare për raportim vjetor financiar. Vlera e obligimeve të shpalosura është 148,865€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014.

Rekomandimet

Çështja 10 – Rritja e obligimeve të papaguara - Prioritet i lartë

E gjetura Obligimet e papaguara të vitit 2013 janë rritur dukshëm krahasuar me përfundimin e vitit 2012. Obligimet e papaguara të shpalosura në PVF e vitit 2012 ishin në vlerë prej 3,200€ përderisa obligimet e vitit 2013 janë në vlerë prej 148,865€. Prej tyre, 90% i takojn obligimeve të papaguara për investime kapitale.

Obligimet e papaguara për investime kapitale kishin rrjedhur si pasoj e mos planifikimit me kohë të projekteve kapitale. Mangësit lidhur me këtë i kemi shpalosur në kapitujt më lartë. Përderisa, në një numër të obligimeve për mallra dhe shërbime në vlerë prej 4,100€ arsyeja e mos pagesës ishte mungesa e buxhetit për kategori të caktuara.

Rreziku Rritja e obligimeve të papaguara është indikator për menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal dhe ndikon në buxhetin e vitit vijues. Po ashtu, hyrja në obligime në munges të buxhetit mund të rezultoj në pamundësinë e pagesës së tyre.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet për projekte kapitale janë planifikuar me kohë me qëllim që obligimet të mos ngarkojn buxhetin e vitit vijues. Veç kësaj, duhet të siguroj që para incimit të furnizimit me mallra dhe shërbime ekziston buxhet i mjaftueshëm për pagesë të tyre.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm.. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

MAPL ka themeluar njesinë e auditimit të brendshëm e cila përbëhet nga drejtori i auditimit të brendshëm dhe dy zyrtar të auditimit (njëri prej zyrtarëve është angazhuar në fillim të vitit 2014).

MAPL ka themeluar komitetin e auditimit i cili përbëhet prej tre antarëve. Gjithashtu në përputhje me ligjin e auditimit të brendshëm, komiteti ka aprovuar edhe statutin e komitetit të auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2013, në të cilin ka paraparë kryerjen e pesë (5) auditimeve të rregullta dhe auditime sipas kërkesës. Kjo njësi gjatë vitit 2013 ka kryer katër (4) auditime të rregullta dhe tri (3) auditime me kërkesë, përderisa nuk ka kryer auditimin “sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale” siq ishte parapar në plan. Raportet e auditimit të brendshëm kanë rezultuar me të gjetura dhe rekomandime.

NJAB ka përgatitur raporte tremujore dhe vjetore për punën dhe aktivitetet e saj. Gjithashtu raportet tremujore i ka dërguar në NJQHAB.

Gjatë vitit komiteti kishte mbajtur gjithsej tri (3) takime të rregullta, ku është diskutuar për raportet tremujore të NJAB, planin strategjik dhe çështje të tjera lidhur me auditimin e brendshëm.

Rekomandimet

Çështja 11 – Prioritizimi i kryerjes së auditimeve në bazë të vlerësimit të rrezikut - Prioritet i mesëm

E gjetura Njësia e auditimit të brendshëm ka realizuar shumicën e auditimeve të cilat i kishte planifikuar, mirëpo kjo njësi nuk ka arritur ta kryej auditimin “Sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale” auditim i paraparë në plan. Me këtë nuk ka arritur t’a mbështet menaxhmentin e MAPL-së për funksionimin e kontrolleve në fushën e menaxhimit të investimeve kapitale.

Rreziku Një program i papërfunduar i NjAB-së zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrolleve në menaxhimin e shpenzimeve përmes prokurimeve (investimeve kapitale). Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të punojë me Drejtorin e NjAB-së për të siguruar që ofrohet siguri e mjaftueshme nga NjAB për funksionimin e kontrolleve në fushat ku vlerësimi i rreziqeve është paraparë i lartë. Në vitet e ardhshme përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së duhet të monitorohet nga Komiteti i Auditimit çdo dy muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për

Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rekomandimet e vitit paraprak (2011)	Menaxhmenti duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar- dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe.	X		
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Çështja - Ekzekutimi i Buxhetit jo si duhet – Prioriteti i rëndësishëm Menaxhmenti duhet t'i vlerësojë në mënyrë sistematike arsyet për reduktimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit në vitin 2012 dhe ti përcaktojë opcionet praktike për përmirësimin e kësaj dhe profilit të shpenzimeve nëpër tërë vitin. Kjo mund të përfshijë: Punën me komunat për të siguruar që është shmangur çfarëdo mangësie potenciale në proceset e prokurimit; Punën me organizatat tjera buxhetore për t'u munduar të ndikohet në proceset e prokurimit për të promovuar procese më të ngjeshura të cilat i reduktojnë vonesat kohore dhe potencialin për vërejtje në proces; Monitorimin proaktiv të niveleve të mundshme të shpenzimeve në nivelin e nën-kategorive, ndërlidhja me MF-në për t'i kthyer fondet të cilat nuk pritët të përdoren; Shqyrtimin e proceseve të planifikimit të buxhetit për t'u siguruar që ato janë të qëndrueshme.		X	

	Çështja - Evidentimi i shpenzimeve në kode të pasakta-Prioriteti- Të tjera Menaxhmenti, duhet të sigurojë që kontrollet janë zbatuar për të siguruar që shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere janë shpenzuar vetëm në këto fusha.			X
4.4 Shpenzimet 4.4.1 Prokurimi	Çështja - Financimi i projekteve komunale me mangësi- Prioriteti - I rëndësishëm Menaxhmenti i MAPL-së duhet që, paraprakisht të sigurojë zotimin e fondeve buxhetore për komunat në mënyrë që projektet e dakorduara me marrëveshje të mund të realizohen në linjë me kontratat e arritura dhe me kohë. MAPL, duhet të vendosë monitorim efektiv për të siguruar që rrjedha e parasë së komunës përputhet me kërkesat e projektit dhe të sigurojë që komunat nuk hyjnë në kontrata para se të nënshkruhet një Memorandum i Marrëveshjes formale. Çështja - Vonesa në realizimin e punimeve - Prioriteti - I rëndësishëm Menaxhmenti duhet t'i identifikojë shkaktarët për vonesat në kryerjen e projekteve dhe marrjen e veprimeve për t'u siguruar që projektet të përfundohen brenda afateve kohore të pritshme. Penalet duhet të zbatohen ku ka nevojë për ta mbështetur këtë proces. Çështja - Ndryshimi i pozicionit në faturë nga raporti i pranimi të mallit - Prioriteti - Të tjera Menaxhmenti duhet të shtojë kontrolle të mbikëqyrjes shtesë në proces për t'u siguruar se artikujt e pranuar janë ata që janë kërkuar dhe faturuar.	X X	X	

	Çështja - Ekzekutim i pagesës pavarësisht që specifikacionet e kontratës nuk janë përmbushur - Prioriteti - Të tjera Menaxhmenti duhet t'i rishikojë arsyet pse një pagesë është bërë pa u përmbushur kërkesat e kontratës për t'u siguruar që kjo situatë të mos përsëritet.	X		
4.4.2 Shpenzimet tjera	Çështja - Mangësi në kontrolle në lidhje me udhëtimet zyrtare - Prioriteti - I Rëndësishëm Udhëtimet zyrtare duhet të financohen nëse mbështeten nga një rast i fuqishëm i punës zyrtare që e arsyeton qëllimin e udhëtimit. Duhet të miratohen rregullore që i specifikojnë obligimet e MAPL-së ndaj stafit të përfshirë në udhëtime zyrtare që nuk është i MAPL-së. Kontrollat që kanë të bëjnë me avanset duhet të shqyrtohen dhe të ngritet niveli i tyre aty ku ka nevojë.		X	
4.4.4 Subvencionet dhe Transferet	Çështja - Anashkalimi i marrëveshjeve për subvencione - Prioriteti - Tjetër Menaxhmenti duhet t'i shqyrtojë kontrollet ekzistuese që kanë të bëjnë me subvencionet, dhe të përcaktojë nëse mund të ndërmerren veprime shtesë për të siguruar arritjen e veprimit të dakorduar- kjo mund të përfshijë pagesë në faza që e reflektojnë pranimin e raporteve të kërkuara, etj.			X
4.5 Pasuritë 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Çështja - Regjistri jo i plotë i pasurisë - Prioriteti - I rëndësishëm Menaxhmenti, duhet të sigurojë se regjistrat e pasurisë janë harmonizuar formalisht në raportin e inventarizimit dhe që të gjitha informatat janë inkorporuar brenda regjistrat apo janë mirëmbajtur veçmas ashtu si duhet.			X
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Çështja - Mos raportimi me kohë në NJQHAB NJAB duhet ta vë theksin në dorëzimin me kohë të raporteve në NJQHAB, respektivisht 15 ditë pas përfundimit të çdo tremujori.	X		